



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 16-11442 /15
Kaçanik, 01.04.2015

Në bazë të nenit 12, 17 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 9, 12, 14 dhe 17 alinea 2 e Rregullores 01Nr. 16-27192/12 -Për caktimin e kriterëve për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, të nenit 2.2 të Rregullores 01Nr. 16-18737/13-Për ndryshim plotësimit të Rregullores 01Nr. 16-27192/12 -Për caktimin e kriterëve për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, të dispozitave të Rregullores 01Nr. 16-1846/13 për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Kaçanikut, si dhe nenit 2 të Rregullores 01Nr. 16-10142 për ndryshim plotësimit të Rregullores 01Nr. 16-10142/15 për ndarjen e bursave të studentëve të komunës së Kaçanikut, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 01.04.2015, mori këtë,

V E N D I M
PËR NDARJEN E BURSIVE TË STUDENTËVE TË KOMUNËS SË
KAÇANIKUT PËR VITIN AKADEMIK 2014/2015

1. Me këtë Vendim lejohet ndarja e Bursave për studentët e komunës së Kaçanikut për vitin akademik 2014/2015 në shumë 20.000.- €, (njëzetmijë euro), të parapara me buxhetin e komunës për vitin 2015.
2. Shuma e mjeteve nga pika 1. e këtij vendimi do të shpërndahen për 50 bursa, në shumën mujore nga 40 € për një student, për një vit akademik, respektivisht për 10 muaj.
3. Mjetet buxhetore nga pika 1. e këtij Vendimi do të realizohen nga kategoria ekonomike e shpenzimeve të Subvencioneve dhe Transfereve nga Programi Buxhetor i Zyrës së Kryetarit(16028/200).
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, ndërsa ekzekutimin financiar do ta bëjë Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës, dhe do të zbatohet në kohëzgjatje prej dhjetë(10) muaj, për aq sa zgjatë viti akademik 2014/2015.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës,
3. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe
4. Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhehal Gashi